

Kërcënoi se do vriste një person, arrestohet 35-vjeçari në Mirditë



10:47 - 16 Maj, 2020



Policia e Mirditës ka vënë në pranga një 35 vjeçar, pasi ka kanosur me armë zjarri një shtetas. Uniformat blu kanë bërë me dije se ai ka e kërcënuar se do ta vriste, por falë ndërhyrjes së menjëhershme të Policisë është ndaluar përshkallëzimi i mëtejshëm i konfliktit.

I ndaluar është shtetasi me iniciale E. Sh., 35 vjeç, banues në Nderfane, Mirditë, i cili akuzohet për veprat penale “Kanosja”, “Armëmbajtja pa leje” dhe “Shkatërrim prone”.

Njoftimi i policisë:

Parandalohet përshkallëzimi i mëtejshëm i një konflikti mes dy personave.

Kanosi me armë zjarri një shtetas, duke e kërcënuar se do ta vriste, falë ndërhyrjes së menjëhershme të Policisë u vu në pranga 35-vjeçari.

Sekuestrohet një armë zjarri pistoletë.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Mirditë, pas njoftimit të marrë se në Rrëshen, Mirditë, kishte konflikt mes dy shtetasve, ku një prej tyre kishte dhe armë zjarri, kanë shkuar menjëherë në adresën e dhënë, ku kontaktuan se:

Shtetasi E. Sh., pas një konflikti të çastit, për motive të dobëta, me shtetasin V. P., i kishte thyer xhamin e makinës këtij shtetasi dhe po e kërcënonte me armë zjarri për ta vrarë.

Në momentin që shërbimet e Policisë janë afruar në vendin e ngjarjes, shtetasi E. Sh. është larguar me shpejtësi, por nuk ka mundur dot të largohet pasi është kapur pas disa minutash ndjekjeje nga shërbimet e Policisë Mirditë.

Gjatë kontrollit fizik shërbimet e Policisë i gjetën armën e zjarrit pistoletë me të cilën ky shtetas kishte kanosur për vrasje shtetasin V. P.

Në përfundim të veprimeve u bë arrestimi i shtetasit E. Sh., 35 vjeç, banues në Nderfane, Mirditë, për veprat penale në ngarkim të tij “Kanosja”, “Armëmbajtja pa leje” dhe “Shkatërrim prone”.

Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për veprime të mëtejshme./abcnews.al

Aktualitet

Armë

Kanosje

Mirdite

Të ngjashme



Kërcënoi me armë 29-vjeçaren, arrestohet 57-vjeçarja! I gjendet..



“Ky djali ka armë”: Si u dekonspirua nga qytetarët ..



Grabitësit tmerrojnë familjen me 5 anëtare, kryefamiljarja: Na ..

Like Share 71K people like this. Sign Up to see what your friends like.



21:11 - 16 Maj, 2020

Grekët dynden plazheve, vendi goditët nga i nxehti afrikan



20:26 - 16 Maj, 2020

Pampuri në shtëpinë e djalit të dhunuar: I rrisim fëmijët me mund, na i...



20:06 - 16 Maj, 2020

Akokati i Popullit nis shqyrtimin e dhunës ndaj të miturit: Masat ndaj...



19:44 - 16 Maj, 2020

Avokati i Jael Çelës shpjegon rrethanat e dorëzimit: lu shmang...



19:03 - 16 Maj, 2020

VETTING/ Anti-konformisti



18:21 - 16 Maj, 2020

Njëllor si “Eskobari i Ballkanit”, Artan Hoxha zbardh detajet e dorëzimi...



18:03 - 16 Maj, 2020

Pandemia kthen nostalgjinë në Fier, me biçikletë në Seman



15:57 - 16 Maj, 2020

Rritja e shifrave, ISHP këshillon qytetarët: Merrni ushqime për 1 javë, mban...

Rreth nesh

ABC NEWS është i pari televizion në Shqipëri që në ditën e parë të transmetimeve nis me lidhje direkte nga 7 studio lokale ne Shkodër, Durrës, Elbasan, Korçë, fier, Vlorë e Gjirokastr. Për të pasuruar gjeografinë e informacionit së shpejti do të mundesohet edhe studio nga Lezha me transmetime live në cdo kohë. Në faqen zyrtare në internet, abcnews.al do të gjeni portalin më të pasur ballkanik me lidhje në rrjetet më të mëdha sociale facebook, twitter si dhe në një prej websiteve më të fuqishëm në kulturën e internetit YOUTUBE. Transmetimi i ABC news është live 24 ore. NUIS/NIPT K01711004F

Harta e faqes

Aktualitet

Politikë

Rajon

Sport

Botë

Ekonomi

Emisione

Moti

Showbiz

English

